

## Guardiola: Messi kurrë nuk është ankuar

***Trajneri i Barcelonës, Josep Guardiola, ka dalë në mbrojtje të lojtarit të tij më të mirë dhe thotë se Lionel Messi kurrë nuk është ankuar për shkak të faulleve të shpeshta.***

Argjentinasi ishte cak i lojtarëve kundërshtar në ndeshjen ndaj Realit dhe ndaj tij u bënë disa starte të rrezikshme. Messi më vonë u ankua se simulon në faullet, por Guardiola thotë se kjo nuk është e vërtetë dhe se argjentinasi kurrë nuk është ankuar.

“Nuk i pranoj akuzat ndaj Messi. Ai kurrë nuk është ankuar. Stili i tij i lojës krijon shumë kontakte. Por ai gjithmonë në mënyrë të guximshme iu reziston dueleve”, ka thënë Guardiola.

“Nëse ka faull, fajtor është lojtarë që e ka shkaktuar atë dhe jo ai ndaj të cilit është bërë faulli”, ka shtuar spanjoli.

Burimi: <http://www.cdodite.com/20081221130528/Guardiola-Messi-kurre-nuk-eshte-ankuar.html>